


**THE PRINCIPLES  
OF ATHLETIC COMPETITION**

*Practicing the Presence of God*



**THE PRINCIPLES  
OF ATHLETIC COMPETITION**

*Practicing the Presence of God*

**PARIMI I KONKURENCËS  
SPORTIVE**

***Përjetimi i Pranisë së  
Dorëndisë***

# *Athletes inAction.*

*Sportistët në Veprim është një shërbesë sportive të Institutit “Jeta Re”*

*I. P.O. Box 588, Lebanon, Ohio 45036.*

*(513)933-2421. Printimi I Dytë, 1995.*

## **PËRMBAJTA**

<b>PARATHËNIE.....</b>	<b>4</b>
<b>MËSIMI 1 SPORTISTI I KOMPLETUAR.....</b>	<b>8</b>
<b>MËSIMI 2 QËLLIMI HYJNOR.....</b>	<b>20</b>
<b>MËSIMI 3: PIKAT KRYESORE ÇFARË DO TJU MBAJË TË FOKUSUAR TEK E VËRTETA?.....</b>	<b>31</b>
<b>MËSIMI 4 MOTIVIM MAKSIMAL.....</b>	<b>38</b>
<b>MËSIMI 5 SALLONI I BESIMIT.....</b>	<b>47</b>
<b>MËSIMI 6 FUQI NGA LARTË.....</b>	<b>53</b>
<b>MËSIMI 7 PERFORMANCA QË I SJELL LAVDI PERËNDISË.....</b>	<b>62</b>
<b>MËSIMI 8 VËSHTIRËSI ME SIGURI.....</b>	<b>70</b>
<b>MËSIMI 9 MBAJINI SYTË TEK ÇMIMI.....</b>	<b>78</b>
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>86</b>

## PARATHËNIE

Konkurenca. Motivimi. Frika. Dëmtimi. Këmbëngulja. Vetkontrolli.

Sportistët e Krishterë përballen me këto çështje çdo ditë. Por ku është Perëndia? Ai është aty me ty- duke pritur të punojë në ju dhe nëpërmjet jush në çdo aspekt të jetës sportive, në dhomën e zhveshjes, në fushën e stërvitjes, gjatë lojës –ju mund të përjetoni praninë dhe fuqinë e Perëndisë. Ky studim është i hartuar për tju ndihmuar të zbatoni parimet biblike në konkurimin sportiv; të mund të kuptoni – nga pikëpamja e Perëndisë- qëllimin tuaj në aktivitetet sportive dhe në jetë, është hartuar tju ndihmojë të zbuloni gëzimin ndërsa *Përfitoni nga Prania e Perëndisë*.

Aktivitetet Sportive janë si jeta në një kapsulë: Drithërima e fitores dhe agonja e humbjes! Ajo që jeta të jep është e mbështjellë me aktivitetet sportive.

Mënyra sesi do ti përgjigjeni zgjarrit së konkurimit, shpesh është e njëjta mënyrë sesi i përgjigjeni presionit të jetës. Parimi I konkurrencës sportive do t'ju ndihmojë të zbatoni fjalën e Perëndisë situatat e çdo dite, kështu do të jeni më të përgatitur të përballeni me jetën.

Çdo mësim është i ndarë në tre pjesë: **E Vërteta e Analizuar** zbulon se çfarë ka për të na thënë lidhur me këtë subjekt. Pjesa e kryeore do të përmendet përsëri tek **E Vërteta e Thjeshtëzuar** Më së fundi, koncepti do të aplikohet tek përvoja juaj sportive, që do ta përmendim tek **E Vërteta e Zbatuar**. Në çdo kapitull kemi një zhvillim natural nga të kuptuarit deri tek praktimi i çdo parimi në konkurim dhe në jetë. Çdo parim na jep një mundësi më të qartë për të sjellë të vërtetën e pranisë së Perëndisë nga një moment i realitetit tek tjetri.

Ndonëse këto dhe shumë parime të tjera janë të gërshetuara me njëra-tjetrën gjatë gjithë Fjalës së Perëndisë, ne kemi zgjedhur një pasazh kryesor të Shkrimeve

Do të fillojmë nga Filipianët 3:8-14, nga më pas do të vazhdojmë. Këtu apostulli Pal thotë se adhurimi ynë si i krishterë është i dallueshëm (vargjet 1-3). Gjithashtu Ai na kujton se këto parime që përmenden në vargjet 4-7 errësojnë aftësitë dhe arritjet e tjera sportive .

**<sup>8</sup>E për më tepër, të gjitha gjërat i llogarita si humbje për atë që është shumë e madhe: njohjen e Krishtit Jezus, Zotit tim, për të cilin të gjitha i humba dhe i quaj hedhurina që të fitoj Krishtin**

**<sup>9</sup>dhe të gjendem në Të, duke mos pretenduar ta kem drejtësinë time prej Ligjit, por atë që vjen nëpërmjet besimit në Krishtin, *domethënë drejtësinë që buron nga Perëndia në***

bazë të besimit.

<sup>10</sup> Dua ta njoh Krishtin, fuqinë e ngjalljes së Tij dhe pjesëmarrjen në vuajtjet e Tij, duke i ngjarë Atij në vdekje,

<sup>11</sup> me shpresën se mund të arrij në ngjalljen nga të vdekurit.

<sup>12</sup> Jo se tani e kam arritur këtë, apo kam arritur të jem i përkryer, por po rend se ndoshta e kap atë për të cilën edhe unë jam kapur nga Krishti Jezus.

<sup>13</sup> Vëllezër, unë nuk e llogaris veten *si një njeri* që e ka arritur, por një gjë *bëj*: harroj ato që janë prapa dhe përpiqem të arrij ato që janë përpara,

<sup>14</sup> rend me synimin për të marrë çmimin e thirrjes qiellore të Perëndisë në Krishtin Jezus.

<sup>15</sup> Pra, te gjithë ne qe jemi te persosur, le te kemi keto mendime; dhe ne qofte se ju mendoni ndryshe per ndonje gje, Perendia do t'jua zbuloje edhe kete.

<sup>16</sup> Por ne piken ku kemi arritur, le te ecim sipas se njetjes rregull me te njejtën mendje.

<sup>17</sup> Behuni imituesit e mi, vellezer, dhe vereni ata qe ecin keshtu, sipas shembullin qe keni ne ne.

<sup>18</sup> Sepse shume nga ata, per te cilet ju kam folur shpesh, edhe tani po jua them duke qare, ecin si armiq te kryqit te Krishtit.”

*(Filipianët 3:8-18)—Apostulli Pal*

Më vonë në këtë pasazh, ne zbulojmë se ndërsa maturohemi (vargu 15), ne zbulojmë se këto të vërteta do të ndikojnë në jetët tona. (vargu 16). Ndërsa i praktikojmë ato (vargu 17), Perëndia do ti ndryshojë jetët tona (vargu 21). Ne do të bëhemi sportistët më të mire- të mundshëm! Historia e “Luani brenda jush”, e ilustron më së miri procesin e punës së Perëndisë në ju:

### Luani brenda Jush

*Një ditë, një djalë i vogël vuri re një kamion i madh që po ecte mbrapsht për tek shtëpia e komshiut. Ndërsa po shikonte, ai pa një burrë që po shkarkonte një copë shkëmbi gjigand dhe të çuditshëm. Kurioz, ai ngau biçikletën më afër që të mund të shikonte më mire dhe ndërsa ia kishte ngulur sytë burrit që po mbante këtë shkëmb graniti për tek shtëpia e komshiut, ai pyeti komshiun, “çfarë është kjo?”.*

*Komshiu iu përgjigj “ Është një cope graniti”*

*“E çfarë do të bësh me të?”- e pyeti djali i vogël*

*Komshiu i tij iu përgjigj, “Unë jam një skulptor dhe kam në plan të bëj një skulpturë ”*

*“A mund të të shikoj kur e bën?” e pyeti djali i vogël me kërshëri*

*“Patjetër”- i tha burri.*


*Pastaj skulptori u largua, filloi të heqë disa cifla të granitit, pastaj të largojë disa copa më të mëdha dhe pastaj ato më të voglat. Ndërsa komshiu përpaste copëzat me zhurmë përtokë, minutat kalonin dhe u bënë orë.*

*Entuziazmi i djalit nuk zgjati shumë, kështu ai shkoi në shtëpi. Disa javë më vonë, djali u kthye tek shtëpia e komshiut, kurioz për të parë se çfarë pamje kishte marrë graniti. Komshiu e drejtoi djalin tek dhoma dhe kur ai ishte tek dera, sytë e tij u hapën sa një kokërr rrushi. I mrekulluar, ai qëndroi aty duke ia ngulur sytë skulpturës më të bukur, më të ndërlikuar, më të lëmuar dhe të detajuar që kishte parë ndonjëherë, ishte skulptura e një luani! Me gojën e tij gjysëm të hapur, ai i tha me ngazëllim komshiut të vet: “ Uau si e dije se ishte në luan brenda atij graniti?”*

A mund ta imagjinoni? Perëndia, Projektuesi dhe Krijuesi i universit është Projektuesi dhe Skulptori i jetës tënde. Ai dëshiron ti orkestrojë “situatat” e jetës tënde, të të gdhend dhe të të lëmojë për të bërë një vepër arti të përsosur, madje edhe nëpërmjet aktiviteteve sportive. Këto parime janë një pjesë e projektit të Perëndisë për të bërë një kryevepër!

Nëntë mësimet pasardhëse janë vetëm fillimi i parimeve thelbësore në fjalën e Perëndisë. Ato janë projektuar për tju ndihmuar të zbuloni qëllimin e Tij për jetën tuaj. Ne shpresojmë të kënaqeni ndërsa mësoni të përfitoni nga prania e Perëndisë nëpërmjet zbatimit të këtyre të vërtetave të jetën tuaj!

**A merrni pjesë në garë?**



*Mësimi 1*

## **SPORTISTI I KOMPLETUAR**

*"Ilogarita si humbje për atë që është shumë e madhe: njohjen e Krishtit Jezus,"*

Çdo sportist serioz e fokuson energjinë e tij drejt arritjes së qëllimeve që ka vendosur. Përmasat fizike, mendore dhe shpirtërore janë të gjitha të rëndësishme për të zhvilluar në sportist të kompletuar. Një sportist i kompletuar është ai i cili me anë të një marrëdhënie personale me Perëndinë përpiqet të arrijë potencialin e tij fizik, mendor dhe shpirtëror. Ky mësim do të shqyrtojë disa nga barrierat në secilin nga këto 3 fushat dhe se çfarë ka për të na thënë fjala e Perëndisë, Bibla, për secilin prej tyre.

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

- <sup>3</sup> *sepse ne jemi rrethprerja e vërtetë, ne që shërbejmë në Frymë Perëndie dhe lëvdohemi në Krishtin Jezus dhe që s'kemi besim në mishin,*
- <sup>4</sup> *megjithëse unë vetë kam arsye përse të besoj në mishin. Nëse ndonjë tjetër kujton se ka arsye përse të besojë në mishin, unë edhe më tepër:*
- <sup>5</sup> *i rrethprerë ditën e tetë, nga kombi i Izraelit, i fisit të Beniaminit, hebre prej hebrenjsh, sipas Ligjit, farize;*
- <sup>6</sup> *sa për zell, përndjekës i kishës, sa për drejtësi që është në Ligjin, pa të meta.*
- <sup>7</sup> *Por çfarëdo që për mua ishte fitim, tani e quaj si humbje për Krishtin.*
- <sup>8</sup> *E për më tepër, të gjitha gjërat i llogarita si humbje për atë që është shumë e madhe: njohjen e Krishtit Jezus, Zotit tim, për të cilin të gjitha i humba dhe i quaj hedhurina që të fitoj Krishtin.”*
- Filipianët 3:3-8



4. Rendit disa nga ligjet që ndikojnë në gjendjen fizike të një personi.
  
  
  
  
  
  
  
  
  
  
5. A është e mundur për një të krishterë të anashkalojë këto ligje dhe përsëri të ketënjë gjendje të mire fizike? Pse po ose pse jo?
  
  
  
  
  
  
  
  
  
  
6. Si lidhen vargjet e mëposhtme me këto parime? Fjalët e Urta 4:14:23; 20:4

### *Dhimbja*

Të qënit një sportist serioz shpesh përfshin shkallmimin e “barrierës së dhimbjes”. Gjatë stërvitjes ose konkurimit, ndoshta keni përjetuar barrierën e dhimbjes- pikërisht në ato momente kur dhimbja e padurueshme thërret nga trupi “Mjaft, mjaft!”

7. Kur trupi lutet për të hequr dorë, çfarë ju bën të vazhdoni?
  
  
  
  
  
  
  
  
  
  
8. Sipas 1 Korintasve 9:24-27, çfarë na është thënë të bëjmë me trupat tanë? Dhe si e bëjmë këtë gjë?

## **BARRIERAT MENDORE**

### *Frika*

Çdo sportist, gjatë karrierës së tij, ndeshet me frikë në një moment ose në një tjetër. Kjo frikë pengon mprehtësinë tuaj mendore dhe gatishmërinë emocionale ose ju jep një shytje shtesë të adrenalines dhe kjo situatë shkon në favorin tuaj.

9. Si një sportist, me çfarë lloj frikërash ndesheni

10. Si dëshiron Perëndia tu përgjigjeni këtyre situatave sipas Filipianët 4:6-7 dhe Psalmit 56:3-4?

### *Qëndrimet e pakëndshme*

11. Përshkruaj disa nga qëndrimet e pakëndshme që keni përjetuar ose dëshmuar në lojë?

12. A ndikojnë tek ju këto lloj qëndrimesh? Si?

13. Sipas Filipianëve 2:14-15,4:8 dhe Kolosianëve 3:23, si dëshiron Perëndia ti trajtoni këto qëndrime?

## **BARRIERAT SHPIRTËRORE**

*Mëkati dhe ndarja jonë nga Perëndia*

Shpesh, ne kemi parë se barrierat mendore dhe fizike kapërcehen përmes një pune të palodhur, disiplinës dhe vendosshmërisë. Megjithatë, barrierat shpirtërore, kurrë nuk mund të kapërcehet me anë të forcave tona. Është pikërisht barrierat shpirtërore që nuk na lejon të behemi një sportist i kompletuar.

14. Si do ta parafrazoni me fjalët tuaja Romakët 3:23?

Mëkati është më shumë se një mashtrim, gënjeshtëri apo sjellje imorale. Këto veprime vijnë vetëm nga të paturit një qëndrim mëkatar. Mëkati është thjesht të *bërit* e asaj që duam dhe *jo i asaj që Perëndia do* - si në veprime edhe në qëndrime.

15. Cila është pasoja (paga që meritojmë) e mëkatis? Romakët 6:23

Mëkati na sjell ndarjen nga Perëndia. Kjo na ndalon nga gjithçka që mund të jemi edhe si person edhe si sportist. Pa një marrëdhënie me Krishtin, është e vështirë të operojmë në të dyja dimensionet.

16. Çfarë na ka dhënë Perëndia? Romakët 5:6-8

Vdekja e Jezus Krishtit në kryq është paga që do të na duhet të paguanim për mëkatin tone. Duke vdekur në vendin tone, Ai bëri të mundur të kishim përsëri marrëdhënie me Perëndinë.

17. Çfarë e nxiti Perëndinë të siguronte për ne këtë gjë? Romakët 5:8

18. Çfarë na thotë Gjoni 14:6 për rrugën për tek Perëndia? Sa rrugë ka për tek Ai?

Ne duhet ta pranojmë Jezus Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin tone me anë të besimit, që Ai të mund të largojë barrierat shpirtërore që na ndajnë prej tij. Ky është një vendim i marrë me besim (i zë besë), ku ne besojmë tek Krishti dhe vdekja e Tij si paga jonë për mëkatin.

19. Sipas vargjeve të mëposhtme, si i kuptoni fjalët të pranosh Krishtin?

Gjoni 1:12:

Efesianët 2:8-9:

## **E VËRTETA E ZBATUAR**

20. A e keni vendosur besimin tuaj tek Krishti, duke e pranuar Atë si Zotin dhe Shpëtimtarin tuaj?

Nëse nuk e keni marrë më pare këtë vendim por do të kishit dëshirë ta merrnit tani, lutja e mëposhtme është një mënyrë sesi tia shprehni atë dëshirë Perëndisë.

*“Zot Jezus, unë dëshiroj të të njoh Ty më shumë personalisht. Faleminderit që ke vdekur në kryq për mëkatet e mia. Unë e hap derën e jetës sime dhe të pranoj personalisht si Zotin dhe Shpëtimtarin tim. Merre në kontroll jetën time dhe më bëj personin që Ti dëshiron që të jem.”*

21. A do të doje të kishe një moment për të shprehur besimin tend tek Krishti?

22. Si sollli në jetën tuaj marrëdhënia me Jezus Krishin? Po në rendimentin tuaj sportiv?

23. Si mund të jetë fjala e Perëndisë një instrument për tju ndihmuar të tejkaloni barrierat fizike dhe mendore?

Më poshtë, përmendni disa barrierat dhe përkrah tyre gjeni një varg për secilin

Barrierat	Fjala e Perëndisë
1.	1.
2.	2.
3.	3.

Gjatë javës:

1. Nëse e morët vendimin të pranoni Krishin në jetën tuaj, tregojini dikujt për këtë gjë.
2. Lexo tre kapitujt e pare të Ungjillit sipas Gjonit.
3. Shkruani më poshtë një nga vargjet e tabelës së mësipërme duke patur parasysh një barrierë që po hasni aktualisht në jetën tuaj dhe memorizojeni.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## **PËRMBLEDHJE**

Sportistët që dëshirojnë të arrijnë potencialin e tyre duhet të merren me barrierat mendore, fizike dhe shpirtërore. Hapi i pare drejt të bërit Sportist i Kompletuar, është dorëzimi plotësisht i vetes në dorë të Perëndisë, Është një gjë e mençur të merreni me barrierat dhe limitet tuaja njëra pas tjetrës. Ndërsa e lejojmë Atë të marrë nën kontroll si jetën tone personale ashtu edhe karrierën sportive, ne mund të përjetojmë sigurinë se jemi në procesin e zhvillimit të atij sportisti të kompletuar që Ai dëshiron të jemi.

### **E VËRTETA E THJESHTËZUAR**

***Sportisti i kompletuar  
është ai sportist  
që me anë të marrëdhënies  
së tij personale  
me Perëndinë,  
po kërkon të arrijë  
potencialin e vet sportive***

## **KONTRATA**

Të jesh pjesë e një skuadre, përfshin përkushtimin. Në kolegjet sportive kryesore, ai përkushtim shpesh konfirmohet duke firmosur një letër për këtë qëllim. Në sportet profesionale, kjo praktikë përfshin nënshkrimin e një kontrate. Webster (Webster) e përkufizon një kontratë si “një marrëveshje që lidh 2 ose më shumë palë; një formë e shkruar e hartuar nga të dyja palët si një evidence e kushteve dhe detyrimeve të kontratës”

Me këtë kuptim, Perëndia ju ka ofruar këtë “letër me një qëllim” ose “kontratë” për të qënë në skuadrën e Tij. Kushtet reflektojnë premtimet e Perëndisë dhe përgjegjësitë tuaja. Për shembull, Ai premtton jetë të përjetshme. Kushti i Tij përfshin përkushtimin tuaj për ta pranuar Atë me besim duke i kërkuar falje për mëkatin tuaj dhe duke i besuar se Ai do të bëj pagesën e plotë të mëkatit tuaj. Kur të jeni plotësisht të bindur se dëshironi të pranoni Krishtin, ju mund të dëshmoni përkushtimin tuaj për të qënë në skuadrën e Perëndisë duke nënshkruar këtë shembull kontrate. Kontrata e Tij është hartuar nga karakteri dhe e vërteta e Fjalës së Tij, i firmosur nga Ai me gjak-gjakun e Krishtit.

Kënaquni ndërsa studioni pak nga premtimet e Perëndisë (mos harroni ti lexoni dhe vini re si të përmbushni kushtet e caktura për ju).

# Marrëveshja e Kontratës

## Kontrata Nr.

1. Një marrëveshje e detyrueshme e dy a më shumë palëve
2. Një formë e shkruar e hartuar nga të dyja palët si një evidence e kushteve dhe detyrimeve të kontratës”

*Me anë të së ciës* Zoti Perëndi Madhështor do tia ofrojë kujdo atij që beson dhe dëshiron të hyjë në këtë marrëveshje duke patur parasysh kushtet, detyrimet dhe beslidhjen. Prej kësaj, premtimet e mëposhtme, bëhen të detyrueshme nga Karakteri dhe Fjala e Tij.:

### I. Përfitim

- A. \_\_\_\_\_ 2 Timoteu 3:16,17  
B. \_\_\_\_\_ 2 Timoteu 4:8

### V. Kuptimi

- A. \_\_\_\_\_ 2 Korintasve 4:4  
B. \_\_\_\_\_ Psalm 119:97-100

### II. Begatia

- A. \_\_\_\_\_ Jozueu 1:8  
B. \_\_\_\_\_ Psalmi 1

### VI. Fuqiai

- A. \_\_\_\_\_ Hebrenjtë 4:12  
B. \_\_\_\_\_ Gjoni 16:7, 13, 15; 17:17

### III. Vazhdimësia

- A. \_\_\_\_\_ Ieaja 40:8; Marku 13:31

### VII. Fakti


- A. \_\_\_\_\_ Romakët 12:2

*Në përputhje me rrethanat, parimet e paraqitura në këtë ditë, do të konsiderohen veprime të së tashmes dhe të vazhueshme dhe do të praktikohen si \_\_\_\_\_ edhe në \_\_\_\_\_ siç është përshkruar tek Ligji I Përtërirë 6:1-9 DHE \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ si është përshkruar tek Predikuesit 12:13, 14*

### IV. Mbrojtja

- A. \_\_\_\_\_ Fjalët e Urta 6:20  
B. \_\_\_\_\_ Psalm 119:9-11

# Cili është qëllimi i konkurimit tënd?



*Mësimi 2*  
**QËLLIMI HYJNOR**

*"Rend drejt qëllimit"*

*Ana më e mirë e vetes! Maksimumi. Koha e sprovave fitoret.*

Sportistët duan të kenë mprehtësinë mendore që do ti lejojë ata ta maksimizojnë performancën e tyre. Ndryshimi aftësive fizike midis konkurentëve të tjerë shpesh janë minimale. Sukses në konkurim kanë ata sportistë që konkurojnë me aftësitë e tyre më të mira të mundshme. Qëllimet kanë një pjesë jetësore në mprehtësinë mendore dhe performancën më të mirë. Provo të heqësh qëllimet e një sportisti dhe ndoshta do të vësh re një rënie të konisiderueshme të motivimit të tij.

“SYNO ASGJËNË DHE TË JESH I SIGURT  
SE DO TË PËRFITOSH ASGJË NË ÇDO KOHË!”

1. Përshkruani një nga qëllimet më të larta sportive që ke synuar seriozisht për ta arritur
  
  
  
  
  
  
  
  
  
  
2. A e keni arritur? Nëse po, çfarë ju bëri të vazhdonit me vendosmëri? Nëse jo, pse jo?

Në këtë mësim, ne do të shikojmë se çfarë ka për të na thënë Fjala e Perëndisë për qëllimin përfundimtar të jetës dhe sesi ky qëllim ndikon në të gjitha qëllimet e tjera personale, përfshi edhe sportin.

Apostulli Pali ishte një burrë i destinuar për të qënë numri një. Vitet e një pune të palodhshme dhe të vendosur, e kishin larguar shumë nga miqtë e tij. Por diçka ndodhi që e transformoi të ardhmen dhe qëllimet e tij. Më së fundi ai kishte kuptuar se çfarë do të thoshte të përpiqeshe të arrije qëllimin më të lartë në jetë.

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

<sup>12</sup> Jo se tani e kam arritur këtë, apo kam arritur të jem i përkryer, por po rend se ndoshta e kap atë për të cilën edhe unë jam kapur nga Krishti Jezus.

<sup>13</sup> Vëllezër, unë nuk e llogaris veten *si një njeri* që e ka arritur, por një gjë *bëj*: harroj ato që janë prapa dhe **përpiqem të arrij ato që janë përpara,**

<sup>14</sup> rend me synimin për të marrë çmimin e thirrjes qiellore të Perëndisë në Krishtin Jezus..”

—*Filipianët 3:12-14*

Pasi e kishte rishikuar, një grup goxha mbreslënëse të arritjeve të së shkuarës, Pali na lejon ti hedhim në sy të ardhmes së tij për të arritur një qëllim të ri— “Qëllimi Hyjnor”

## **PIKËPAMJA E DUHUR**

Pikëpamja është mënyra sesi i shikojmë gjërat, ngjarjet dhe jetën. Asnjë person ose sportist nuk merr përsipër të arrijë disa qëllime rastësisht. Gjithmonë ka një perspektivë të caktuar mbi të cilën ai vendos qëllimet: Cilat janë ato shkëmbime që janë të nevojshme? A do tia vlente? Përfitimi dhe vlera që do të marrim prej tyre a e meriton përpjekjen tonë? *Si përshtatet kjo gjë nisur nga kërkessat e konkurimit dhe të interesave*

3. Tek Filipianët 3:4-9, si do ti shprehni shkurtimisht ato arritje për të cilat Pali mburrej?

4. Cilat janë disa nga ato arritje për të cilat ju keni tendecën të mburreni?

5. Në vargun 8, Pali na jep një pikëpamje tjetër kur veprat e mishit ndodhen krah për krah me marrëdhien me Krishtin? Pse?

6. Çfarë do të thotë ti konsideroni prestigjin dhe statusin tuaj “si humbje” para njohjen së Krishtit?

7. Pse Pali e mban *njohjen* e Krishtit si një vlerë e lartë?

Njohja e Krishtit nuk është e bazuar në mbajtjen e disa ligjeve, rregullave të caktuara ose disa arritjeve njerëzore por në besimin e asaj që Ai ka bërë për ne kyrc (shiko Galatasit 2:16).

## **PLANI PERSONAL**

Pasi Pali kishte zbuluar të drejtën për të qëndruar para Perëndisë dhe duke e konsideruar këtë i një vlerë dhe rëndësie të veçantë, Pali përshkruan, në tre pjesë, planin për të realizuar synimin përfundimtar dhe qëllimin për të jetuar.

8. Cilat janë këto 3 pjesët që janë përmendur tek Filipianët 3:10?

---

---

---

9. Çfarë do të thotë ta *njohësh* Krishtin? (fjala “të njohësh” përfshin njohjen empirike (ta njohesh Atë në veprim) dhe jo vetëm intelektuale (në teori)

10. Ringjallja e Krishtit e vërtetoi pushtetin e Tij mbi mëkatit dhe vdekjen. Sa e rëndësishme është kjo gjë për ty ndërsa rriteni në Të?

11. Si ju ndihmon njohja se keni bashkësi me Të në vuajtjet e Tij për të qënë më shumë si Krishti? (Fjala *bashkësi* do të thotë të ndash gjërat së bashku dhe të keni gjëra të përbashkta me njëri-tjetrin)

Ashtu si tha Pali, gjithçka që ai kishte arritur përveçse Perëndisë, e konsideronte një humbje dhe kuptoi se njohja e Krishtit ishte synimi përfundimtar i jetës së tij. Por si i shkoi pas Pali këtij synimi të ri?

## **NË NDJEKJE TË PËRSOSMËRISË**

12. Në vargun 11 dhe 12, Pali thotë se ai po rend drej diçkaje. Çfarë është ajo?

13. Pali dëshiron të jetë i përsosur (i pjekur, i plotë ose i rritur plotësisht). vargi 12 përmbushet duke zbatuar të vërtetën në vargun 14. Çfarë bën Pali të ketë një qëllim që të arrijë pjekurinë në Krishtin?

14. Cilat janë dy parimet të përshkruara në vargu 13 që e aftësojnë Palin të vazhdojë të rend?

a.

b.

15. Çfarë duhet të harroni:

Në jetën tuaj të Krishterë?

Në jetën tuaj sportive?

16. Si do tju ndihmojë harresa e ketyre gjërave në pjekurinë tuaj në Krishtin?

17. Ashtu si një atlet vrapon drejt vijës së finish-it, gjitashtu edhe ju duhet të mbani sytë përpara. Çfarë duhet të shikoni përpara jush që të motivoheni për të vazhuar të rendni?

Çmimi I Krishterë është ringjallja e që do të vijë, por qëllimi ynë është pjekuria në Krishtin! Për ta ilustruar këtë vështrim konsideroni këtë: ëndrra e çdo lojtari të NFL është të fitojë unazën e Supër Vazos. Unaza është çmimi por qëllimi i vërtetë është marrja pjesë në kampionat!



Përgjegjësia juaj është të vazhdoni të rendni me qëllim që ta njihni Krishtin fuqinë e ringjalljes së Tij dhe të qënit në bashkësi në vuajtjen e Tij.

Përgjegjësia e Perëndisë është tju konformojë me imazhin e Tij (Romakët 8:29). Rezultati është pjekuria në Krishtin.

## **E VËRTETA E ZBATUAR**

18. Më poshtë, identifikoni qëllimet kryesore të jetës suaj.

19. Cila nga këto qëllime reflektojnë prioritetin e Qëllimit Hyjnor?

20. Çfarë hapash mund të ndërmerri me qëllim që të njihni Perëndinë më shumë nga afër?

21. Cilat janë disa nga cilësitë e karakterit të Krishtit që mund të zhvillohen përmes:  
Sportit?

Klasës?

Marrëdhënieve?

Gjatë javës:

1. Mbani mend: Filipianët 3:8.

*“E për më tepër, të gjitha gjërat i llogarita si humbje për atë që është shumë e madhe: njohjen e Krishtit Jezus, Zotit tim, për të cilin të gjitha i humba dhe i quaj hedhurina që të fitoj Krishtin.”*

2. Vlerësoni çdo ditë prioritetet tuaja. A jeni të qëndrueshëm me qëllimin tuaj hyjnor? Nëse jo, çfarë keni nevojë të ndryshoni?


## **PËRMBLEDHJE**

Sipas apostullit Pal, njohja e Krishtit me anë të një marrëdhënie besimi, ka vlerë të lartë. Qëllimi Hyjnor për tu rritur në Krishtin ndikon dhe drejton çdo sportist, në qëllimin e tij personal dhe profesional, fizik, social dhe financiar. Qëllimet e tjera janë me siguri të rëndësishme, por ne duhet së pari të kuptojmë qëllimin përfundimtar të Perëndisë me qëllim që të harmonizohemi me planin e Tij dhe me qëllimin e jetës tonë.

### **E VËRTETA E THJESHTËZUAR**

***Qëllimi kryesor në jetë  
është ta njohim Krishtin  
dhe të rritemi në Të.***

# Çfarë do tju mbajë të fokusuar tek e Vërteta?



*Mësimi 3*  
**PIKAT KRYESORE**

*“Zoti do të ta bëj të qartë”*

Në mesin e stërvitjes ose konkurrimit, çdo atlet bombardohet me shpërqendrime. Atleti i Krishterë ka përgjegjësinë shtesë e të jetuarit një jetë që e kënaq Zotin. Ky studim do t’ju ndihmojë të zbuloni se si Pikat Kryesore mund t’ju kujtojnë qëllimin tuaj në konkurrim dhe burimin e fuqishëm të disponueshëm për të ecur me besim.

1. Çfarë lloj shpërqendrimesh has ti si atlet?

2. A është e vështirë për ty të lejosh Krishtin të hyjë në konkurrimin tënd aktual?

Pse, ose pse jo?

Një mesazh në frigorifer. Një shënim në pasqyrë. Një afishe duke ecur nxitimthi. Ne të gjithë kemi nevojë për ‘kujtues’ për të menduar ose bërë diçka të rëndësishme. Për shkak se Zoti nuk do që të harrosh qëllimin e perëndishëm dhe atë që Ai do që ti bësh në jetë, Ai të ka lënë shumë shënime në Bibël për të të kujtuar.

Shumica e Dhiatës së Vjetër është një simbol i dashurisë dhe Hirit të Perëndisë drejtuar fëmijëve të Tij. Përgjatë historisë ai ka përdorur figura dhe simbole për ti ndihmuar ata që të kujtonin fuqinë dhe planin e Tij. Këto “shënime” për ne janë të ngjashme me ato që ne i quajmë pika kryesore. Në faqen tjetër ka shembuj të pikave kryesore verbale, mendore dhe pamore që mund ti përdorim në atletikën tonë.

## **E VËRETETA E ANALIZUAR**

*“Të gjithë ne që jemi të pjekur duhet të kemi një pamje të tillë të gjërave. Dhe nëse në një pikë mendon ndryshe, edhe atë Zoti do të ta bëj të qartë. Vetëm na lejo të jetojmë sipas asaj që tashmë kemi arritur!”*

— Filipianët 3:15-16

## **PIKAT KRYESORE VERBALE**

Lexoni Ligjin e Përtërirë 6:4-11. Vargu 4 thotë, “Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është Një i vetëm”. Zoti po thërret popullin e Tij për ta dëgjuar me qëllim bindjen.

3. Pse mendoni ju se e bëri Zoti këtë një ide të rëndësishme për tu mbajtur mend?

Izraelitët gjithashtu e bënë praktikë përdorimin e një trumbete ose briri dashi si një pikë kryesore vokale për të pasur vëmendjen e popullit. Lexoni Numrat 10:8, 9 dhe Jozueun 6:4, 5.

4. Për çfarë e kujtonte briri i dashit popullin?

### **PIKAT KRYESORE MENDORE**

Lexoni Kolosianëve 3:1-3 dhe Filipianëve 4:8, 9.

5. Cili është paralajmërimi i Palit? Cila pjesë e trupit është pjesë kritike e procesit? Pse është kaq e rëndësishme?

6. Si mund ti të “*mendosh për gjërat e larta ... të cilat janë të vërteta dhe të drejta*” dhe përsëri të jesh mendërisht në konkurrim?

## **PIKAT KRYESORE PAMORE**

Duke përdorur referencat biblike më poshtë, plotësoni fjalën që mungon e cila përshkruan simbolin fizik ose pamor të përdorur për të kujtuar popullin e Zotit për sigurimin (furnizimin) e Tij.

\_\_\_\_\_ këtej dhe matanë Jordanit u kujtonte Izraelitëve kalimin e mrekullueshëm për në tokën e premtuar.

(Jozueu 4:6-7).

\_\_\_\_\_ gjatë ditës dhe \_\_\_\_\_ prej zjarri natën ishin mbrojtja dhe udhëheqja e Izraelitëve për dyzet vjet (Eksodi 13:21, 22).

\_\_\_\_\_ ishte dhe është një kujtim vjetor i sigurimit (ushqimor) të Zotit për njerëzit e Tij të zgjedhur (Eksodi 12:21-27; Numrat 9:2).

7. Si mund t'ju ndihmojë në stërvitjen dhe konkurrimin tuaj parja e pikave kryesore ose 'kujtuesit' e sigurimit dhe planit të Zotit?

## **PIKAT KRYESORE PRAKTIKE**

Shumë atletë të Krishterë kanë përdorur shumëllojshmëri simbolesh si pika kryesore. Qëllimi i pikave kryesore nuk është tërheqja e vëmendjes drejt vetes ose pamjes por për tu kujtuar të vendosni Zotin në qendër të asaj që mendoni, thoni dhe bëni. Ja disa nga më të përdorshmet:

### **Pamje**

*Kryqi* – i ngjitur ose gdhendur në këpucë, kaskë, dorezë, etj. Kryqi është një kujtim i sakrificës së madhe që Krishti pagoi për mëkatit tënd. Mund të kujtoj gjithashtu pozicionin tënd në Krishtin, një trofe Hiri.

*Simboli i peshkut* — Ky simbol është një kujtim i besimit të Krishterëve të hershëm pavarësisht persekutimit të ashpër. Kjo ishte mënyra e tyre e identifikimit të njëri-tjetrit si të Krishterë të vërtetë. Ata ishin të përkushtuar për të qenë një dëshmi me fjalë dhe vepra, pavarësisht kostos.

*Vesh i shënuar* – një copë ngjitës në fund të veshit ose një vëth i veçantë mund të përdoret për të kujtuar se jeni një atlet shërbëtor (doulos), në shpirt. Eksodi 21:1-6. apostulli Pal e quajti veten një shërbëtor skllav të Krishtit, të nënshtruar vullnetarisht ndaj Zotit të Tij në çdo gjë.

### **Fjalë**

*“Gozhdoje”* — Një kujtim që Krishti u gozhdua në kryq për të paguar dënimin e mëkatit. Mund tu thoni, “Gozhdoje” shokëve për tu kujtuar që të gozhdojnë irritimin dhe zemërimin e tyre në kryq (duke e konsideruar veten të vdekur për mëkatit — Romakëve 6) dhe duke mos e lënë të ndërhyjë në konkurrimin tuaj (Kolosianëve 2:13).

*“Vazhdo”* — Një kujtim për të vazhduar drejt pjekurisë në Krishtin ndërsa përballesh me një rendiment ose person të vështirë (Filipianëve 3:14).

*“Përqendroh”* — Një sfidë verbale për tu ri-përqendruar vëmendjen tek Krishti dhe dëshira e Tij për jetën tënde në atë kohë të caktuar (Hebrenjve 12:2).

## **Ana Mendore**

Mësoni përmendësh Vargje për situata të veçanta për tu përdorur si motivim për të jetuar vullnetin e Zotit ose si artileri ndaj tundimit (Psalmi 119:11).

### **E VËRTETA E ZBATUAR**

8. A mund të mendoni për një situatë ku një pikë kryesore mund tu ndihmojë në 'nxehtësinë' e konkurrimit?

Përdorimi i pikave kryesore nuk është zvogëlimi i përqendrimit në sport por për të bërë atë që jeni thirrur të bëni, sipas mënyrës së Zotit. Me fjalë të tjera, mos e lejoni përdorimin e Pikave Kryesore tu shpërqendrojë por përdoreni për të zgjeruar motivimin tuaj të përgjithshëm, mendimet, fjalët dhe veprimet.

9. A ka ndonjë kohë gjatë stërvitjes ose konkurrimit ku ju mund të ri-drejtoni vëmendjen tuaj drejt Zotit pa e humbur përqendrimin në sportin tuaj? Kur?

Përgjatë javës:

1. Bëjeni veten tuaj të përgjegjshëm (bini dakord të përdorni pikat kryesore në mënyrë që të arrini qëllimin e perëndishëm) ndaj një atleti tjetër të Krishterë.
2. Shkruani një letër 3x5 tre pika kryesore që mund ti përdorni në stërvitje ose konkurrim.

3. Shkruani më poshtë disa vargje nga Bibla për ti përdorur si pika kryesore dhe mësojini përmendësh.

A. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

B. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

C. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

4. Listo disa vende ku mund ti vendosni pikat tuaja kryesore për tu ndihmuar ti kujtoni.


## **PËRMBLEDHJE**

Pikat kryesore janë një mënyrë për tu kujtuar juve qëllimin dhe planin e Zotit për ju në sport dhe jetë. Ato mund të jenë pamore, verbale ose mendore. Pikat kryesore më të mira janë ato që ju rrisin në Krishtin duke praktikuar praninë e Zotit në sportin tuaj.

### **E VËRTETA E THJESHTËZUAR**

***Pikat kryesore janë  
përdorur t'ju  
kujtuar qëllimin dhe  
fuqinë e Zotit  
ndërsa konkurron.***

# Çfarë ju motivon të konkurroni?



*Mësimi 4*  
**MOTIVIM MAKSIMAL**

*“Sepse qytetaria jonë është në qiell”*

Motivimi! Sa i rëndësishëm është motivimi? Mund të bëjë të gjithë ndryshimin. Qoftë nëse është shtysa e përditshme për tu stërvitur ose qoftë shtysa shtesë për të thyer pengesat fizike ose mendore, motivimi është çelësi!

**“Motivimi ose na çon më lartë ose na lë të zhgërryhem në mediokritet.”**

Ky mësim do të shqyrtoj përkufizimin e motivimit, faktorët e zakonshëm të motivimit, dhe se si atletët e Krishterët mund të zëvendësojnë motivimet e tij ose saj me motivimin më të lartë që vjen prej Zotit.

1. Si do ta përkufizonit motivimin?

2. Çfarë ju motivon ju gjatë konkurrimit tuaj atletik? Konsideroni faktorët e mëposhtëm të motivimit:

*o vlerësim*

*o para*

*o kënaqësi*

*o miqësitë*

*o krenaria/egoja*

*o fitorja*

*o hakmarrja                      o zemërimi/urrejtja      o frika*  
*o sukcesi                        o pranimi                      o vendosshmëria*

Fjalori Webster e përcakton motivimin në këtë mënyrë:

**Motivi:** ajo brenda individit, më shumë se jashtë, e cila e nxit atë në motivim; ndonjë ide, nevojë, emocion, ose gjendje që shtyn në një veprim.

**Motivimi:** të siguroj me një motivim; të shtyj; nxis.

Motivimi fillon në mendjen dhe zemrën tuaj duke rezultuar në veprim. Atletët janë të motivuar kur ata “i përvishen” pas një objekti dëshire, nevoje ose diçkaje shumë të dëshiruar në të njëjtën mënyrë që një raketë ‘nxehtësie’ i sulet një avioni. Ajo të cilës i “përvishen” atletët në konkurrimin e tyre do të përcaktojë motivimin e tyre dhe, në fund të fundit, rezultatin e tyre.

*“Asgjë nuk ka zgjatur përtej titujve dhe trofeve. Edhe rekordet e mia më të mëdha do të thyhen një ditë. Trofetë po zinin pluhur në papafingo. Dhe një ditë asnjë nuk do të kujtohet më për një basketbollist të quajtur Pistol Pete Maravich i cili ka varur çorapet. Fama dhe ‘të qenit në modë’ ishin të përkohshme dhe të shkurtra! Edhe basketbolli zbuloi më shumë boshllëkun që unë nuk mund ta mbushja. Nuk kisha gjetur një qëllim në të kaluarën e mbushur me sukses, famë dhe pasuri. Për një njeri që dukej sikur kishte gjithçka, në vlerësimin tim nuk kisha një qëllim ... asnjë arsye për të qenë”.*

(Trashëgimi një Ëndrre nga Pete Maravich dhe Darrel Campbell)

3. Kujt iu “përvesh” Pete Maravich si motivim për të?

4. Pse nuk ishte ai i kënaqur?

Shumë herë ne jemi shumë të motivuar nga gjëra që mund të mos na kënaqin ose na ndihmojnë me të vërtet për të arritur potencialin tonë. Kënaqësia e tellë në jetë vjen nga njohja e Zotit. Psalmi 145:16 thotë, *“Ti hap dorën Tënde dhe plotëson dëshirat e çdo gjëje të gjallë.”*

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

*“Sepse shumë nga ata, për të cilët ju kam folur shpesh, edhe tani po jua them duke qarë, ecin si armiq të kryqit të Krishtit, dhe fundi i tyre është humbje, perëndia i tyre është barku dhe lavdia e tyre është në turp të tyre; ata mendojnë vetëm për gjërat tokësore. **Sepse qytetaria jonë është në qiell, prej nga edhe presim Shpëtimtarin, Zotin Jezu Krisht,**”*

— Filipianëve 3:18-20

Pali nuk përdori gjëra tokësore për tu motivuar sepse *qytetaria e tij ishte në qiell*. Ne jemi thirrur të ndjekim shembullin e tij.

5. Çfarë thotë Pali se e kontrollon atë (shtrëngon ose motivon) tek 2 Korintasve 5:9-15.

6. Si e tregoi Jezusi dashurinë e Tij për ne (Romakëve 5:8)?

7. Duke pasur parasysh 1 Gjonin 4:9-10, pse vuajti Jezusi aq mizorisht, mbajti kryqin e tij dhe vdiq në vendin tonë? Cili ishte motivimi i Tij? Në thelb të gjitha motivimeve tona ka një etje të pabesueshme për dashuri të përkryer dhe pranim të përkryer që nuk largohet kurrë. Dashuria e Krishtit është e përkryer; nuk bazohet nëse ia del me sukses ose dështon; është gjithmonë në të mirën tënde. “Përveshja” ndaj dashurisë së Krishtit siguron motivimin më të madh dhe më të qëndrueshëm për një rezultat kulmor.

8. Është brenda kësaj dashurie ku ne zbulojmë *Trofetë e Hirit*. e cila është e vërtet për ne si besimtar në Krisht. Identifiko në listën e mëposhtme mendimet e zakonshme që mund të kesh për veten dhe pastaj shiko se çfarë ka për të thënë Perëndia për secilën.

## **TROFETË E HIRIT:**

### **Besimi fals**

Nuk jam i pranuar.

Kam ngecur, nuk ka shpresë.

Nuk i pëlqej askujt.

Meritoj të ndëshkohem.

Jam vetëm.

Nuk mund të bëj asgjë të saktë.

### **E vërteta për ty**

*Adoptuar:* Ti je adoptuar në familjen e Zotit dhe je fëmija i Tij (Galatasve 4:5-6).

*Shpenguar:* të blesh; do të thotë i çliruar nga pagesa e një haraçi (Efesianëve. 1:7).

*Pajtuar:* Ti ishe i huaj për Perëndinë, tani je plotësisht, pa kushte i pranuar dhe i dashur nga Zoti (Kolosianëve 1:21, 22).

*Justifikuar:* Ti je shpallur i pafajshëm; plotësisht i falur. Jezusi vdiq në kryq për mëkatet e tua.

*Banues:* Prania e Zotit, Fryma e Shenjtë është me ty gjithmonë (Gjoni 14:16,17).

*Me dhunti:* Zoti ka pajisur me dhunti çdo besimtar (1 Korintasve 12:6, 7, 11).

9. Si mund ta ndikojnë motivimin tuaj atletikë këto të vërteta (trofetë e hirit)?

10. Çfarë sugjerojnë ato për vlerën tuaj për Zotin?

“Përveshja” ndaj këtij motivimi të ri, të siguruar prej dashurisë së Krishtit, përmbushet nga besimi. Besimi ka të bëjë thjesht me të zënit besë dhe mirëbesimin, në çdo moment, që ajo që Zoti thotë për ty është e vërtet!

## **E VËRTETA E ZBATUAR**

11. Si mund t’ia kujtosh vetes motivimin tënd të ri gjatë konkurrimit?

12. Listo disa prej karakteristikave të dashurisë së Perëndisë. Përkrahë secilës, shkruaj se si mund të ndikojë rezultatin tënd.

**Karakteristike**

**Ndikon**

a.

b.

c.

Përgjatë javës:

1. Ndërmjet çdo loje ose gjatë kohës së pushimit, pyete veten, “Cili është motivimi im?”

2. Mëso përmendësh 2 Korintasve 5:14-15.

*“Sepse dashuria e Krishtit na shtrëngon, sepse kemi arritur në konkluzionin se, në qoftë se një ka vdekur për të gjithë, të gjithë, pra, kanë vdekur; dhe se ai ka vdekur për të gjithë, me qëllim që ata të cilët jetojnë, të mos jetojnë që sot e tutje për veten e tyre, po për atë që vdiq dhe u ringjall për ta.”*

3. Lutuni nëpërmjet Efesianëve 3:17-19 për veten tuaj dhe për të tjerët.

*“që Krishti të banojë në zemrat tuaja me anë të besimit, që, të rrënjosur dhe të themeluar në dashuri, të mund të kuptoni me të gjithë shenjtoret cila është gjerësia, gjatësia, thellësia dhe lartësia, dhe ta njihni dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri, që të mbusheni me tërë plotësinë e Perëndisë.”*

## **PËRBLEDHJE**

*Me kolonën zanore të filmit “Rroki” në sfond, 6-4, 230 lb, kërcen lëviz vërdallë dhomës duke u përgatitur për konferencën për shtyp.*

*“Kjo muzikë,” komenton ai, “më gjallëron vërtet; jam plotësisht i mbushur dhe i motivuar nga ajo.”  
Pas përfundimit të përsëritjes rraskapitëse, atij iu bë një pyetje depërtuese, “Çfarë ndodh kur muzika mbaron?”*

Asaj që do ti “përvisheni” do të përcaktoj qëndrueshmërinë, fuqinë dhe aftësinë tuaj për të përballuar presionin. Është dëshira e Zotit që dashuria e Jezusit e zbuluar në Trofetë e Hirit të jetë motivimi në sporte dhe jetën e përditshme.

**Parimi #1**  
***Dashuria e Krishtit***  
***është baza (ose objekti)***  
***i motivimit tonë në çdo***  
***gjë që bëjmë.***

# Çfarë po beson rreth Zotit dhe vetes ndërsa konkurron?



*Mësimi 5*  
**SALLONI I BESIMIT**

*“Drejtësia që vjen nga Zoti dhe është nëpërmjet besimit”*

Një atlet i futur në Sallonin e Famës është i nderuar për arritje të mëdha gjatë të karrierës konkurruese. Kjo është vetëm për disa të privilegjuar. Një sallon tjetër pret çdo të Krishterë i cili ka mësuar ti besoj besnikërisht Zotit pavarësisht vështirësisë dhe dyshimit – Sallonin e Besimit. Ky studim siguron shembuj për tu ndjekur nga ju në mënyrë që vazhdimisht ti besoni Zotit në jetën tuaj të përditshme dhe të jeni një prej rekrutëve të Tij për në Sallonin e Besimit.

Hebrenjve 11 përmend 16 burra dhe gra (dhe përmend të tjerë të panumërt) të cilët kanë shkuar para nesh dhe shënuan një shteg besimi ku ne mund të ecim. A ishin këta persona me të meta në karakterin e tyre? A kishin besim të përkryer? A kishin një personalitet ose prirje speciale? Vështirë se po.

1. Cili mendoni se ishte kërcënimi më i zakonshëm në jetën e secilit prej tyre?
2. Si do ta përcaktonit besimin?
3. Lexoni Hebrenjve 11:1. Si përkufizohet besimi?

Webster-i<sup>1</sup> e përkufizon besimin si një *“besim të sigurt në të vërtetën, vlerë ose besueshmëria e një personi, ideje ose gjëje.”*

Besimi Biblik nuk është mendim dëshirues. Nuk është as vendosja e mendjes në neutralitet dhe bërja e një “kërcimi të verbër”. Nuk është besim në *besim* ose përpjekja për të besuar diçka në ekzistencë. Besimi i vërtet biblik është mirëbesim ose zënie besë në vetë Zotin. Ndjenjat dhe rrethanat do të ndryshojnë gjithmonë por Zoti nuk ndryshon kurrë. Vetëm Ai është i mirëbesueshëm për shkak të karakterit të Tij.

4. Cila është e kundërta e besimit? (Shiko 2 Korintasve 5:7).

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

*“dhe që të gjendem në të, duke pasur jo drejtësinë time që është nga ligji, por atë që është nga besimi në Krishtin: drejtësia që është nga Perëndia, me anë të besimit”*

— Filipianëve 3:9

Lexoni Hebrenjve 11:1-29 dhe konsideroni këta shembuj besimi.

- **Enoku** (Hebrenjve 11:5-6) — Bibla thotë se Enoku nuk e përjetoi vdekjen. Ai ishte një njeri që e kënaqte Zotin.

5. Te Zanafilla 5:22-24, çfarë bëri Noeu që e kënaqi Zotin? Çfarë do të thotë kjo?

- **Noeu** (Hebrenjve 11:7) — Besimi i tij e drejtoi të ndërtonte një arkë në mënyrë që ai dhe familja e tij të shpëtonte nga përmbytja, edhe pse nuk kishte rënë kurrë shi.

---

<sup>1</sup> Fjalor

6. Përshkruani besimin e Noeut në vargjet e mëposhtme:  
Hebrenjve 11:7

Zanafilla 6:8, 9

7. A ka ndonjë gjë që Zoti do që ta bësh që ti e di se është e drejtë pavarësisht se si ndihesh?

• **ABRAHAMI** (Hebrenjve 11:8-12) — Abrahami është përmendur shpesh si një njeri i madh i besimit.

8. Në çfarë fushash e tregoi ai besimin e tij sipas këtyre vargjeve?

9. A është e vështirë për ty ti besosh Zotit pa ditur përfundimin? Nëse po, në cilat fusha?

• **SARAH** (Hebrenjve 11:11) — E qeshura e Sarës ndaj premtimit të Zotit u kthye në besim.

10. Lexoni Zanafillën 18:9-15. A ka ndonjë situatë të pamundur për të cilën duhet ti besoni Zotit? Cila është, dhe çfarë kuptimi do të kishte për ju t'ia besoni Zotit këtë situatë?

- **MOISIU** (Hebrenjve 11:23-29) - Moisiu zgjodhi rrugën e vështirë duke mohuar thesaret e Egjiptit për të udhëhequr Izraelitët nga skllavëria për në tokën e premtuar.

11. Si janë këto vepra besimi në sytë e Zotit?

## **E VËRTETA E ZBATUAR**

12. Çfarë thotë Bibla rreth Zotit në vargjet e mëposhtme që të ndihmon të modelosh besimin e këtyre burrave dhe grave?

Hebrenjve 11:16, 39, 40

Hebrenjve 13:5-8

13. Si mund të zbatohet besimi në situatat e mëposhtme atletike? Me fjalë të tjera, për çfarë po i besoni Zotit?

- Pas gjithë punës tuaj të lodhshme, nuk e prekët finishin të parët.
- Trajneri ju nënvlerëson në sy të të tjerëve.
- Keni një mundësi të flisni në një banket sportiv.
- Një javë para eliminatorëve ju dëmtoheni.
- Është 35° celsius dhe ju është thënë të vraponi 8 xhiro 100-she.

Përgjatë javës:

1. Mësoni përmendësh Hebrenjve 11:6.

*“Edhe pa besim është e pamundur t’i pëlqesh Atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë.”*

2. Mendoni për një person që modelon një jetë besimi dhe kaloni kohë me të.

3. Shkruani një situatë që kërkon forcë për ti besuar Zotit dhe lutuni përditë për të.

## **PËRMBLEDHJE**

Pavarësisht të kaluarës së familjes tuaj, personalitetit, ashpërsisë së mëkatit, ose prirjeve. Zoti dëshiron që ti të jetosh me besim dhe jo sipas ndjenjave ose rrethanave. Jo vetëm që ke për ta njohur Atë më personalisht por do ta kënaqësh gjatë procesit dhe Ai do të ta shpërblejë!


***Parimi #2:  
Të jetosh me besim  
(ti besosh Zotit dhe  
premtimeve të Tij)  
është e vetmja mënyrë  
efektive për të  
përjetuar praninë e***

**Si mund të konkurrosh  
qëndrueshmërisht  
sipas standardeve të Zotit?**

**#3**  
**Të qenit i mbushur me**  
**Frymën të jep fuqi për**  
**të jetuar një jetë të**  
**Krishterë të**  
**qëndrueshme brenda**

**Qëllimi**  
**Hyjnor**

**FINISH**



Mësimi 6  
**FUQI NGA LARTË**

*“Njih fuqinë e ringjalljes së Tij”*

*Konsidero këtë situatë: Xhoni kishte edhe baza para se të mbaronte. Në gjuajtjen tjetër Billi, shkel në bazë. Billi fillon të shajë Xhonin, ankohet me inat dhe e përplas shkopin e tij në tokë. Një orë më parë, Billi kishte drejtuar shërbesën dhe kohën e lutjes për skuadrën. Çfarë ndodhi?*

Ky studim do tu ndihmojë të mësoni se si flisni me Zotin vazhdimisht në gjaknxehtësinë e konkurrencës.

1. Çfarë situatash ju tundojnë të prishni ecjen tuaj të Krishterë?

Dikush tha një herë, *“Të jetosh jetën e Krishterë nuk është e vështirë, është e pamundur”*. Kjo është e vërtet nëse përpiqesh ta bësh vet. Zoti dëshiron që të ngrihesh mbi irritimin, ta mundësh dhe të jetosh një jetë fitoreje brenda dhe jashtë fushës — nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë! Fryma e Shenjtë është një person me fuqi. Ai është Zot (2 Korintasve 3:17,18). Pas vdekjes së Jezusit, ringjalljes dhe ngjitjes së Jezus Krishtit, Zoti dërgoi Frymën e Shenjtë për të qenë me ju (Gjoni 14:16, 17). Ai është ai që ju jep fuqi ndaj mëkatit sot dhe, në fund ndaj vdekjes.

**SI I KRISHTERË, TI...**  
***Je i shpëtuar nga dënimi i***  
***mëkatit,***  
***Do të shpëtohesh***  
***nga prania e mëkatit dhe***

## E VËRTETA E ANALIZUAR

*“që të njoh atë dhe fuqinë e ringjalljes së tij dhe pjesëmarrjen në mundimet e tij, duke u bërë vetë i ngjashëm me të në vdekjen e tij, që në ndonjë mënyrë të mund t`ia arrij ringjalljes prej së vdekurish.”*

— *Filipianëve 3:10-11*

2. Lexoni Romakëve 8:11. Cila është marrëdhënia midis Frymës së Shenjtë dhe ringjalljes? Pse është domethënëse kjo për ty?

3. Identifikoni rolet që ka Fryma e Shenjtë në jetën tuaj

- Ai \_\_\_\_\_ mua (Romakëve 8:9).
- Ai \_\_\_\_\_ mua (Gjoni 14:26).
- Ai \_\_\_\_\_ mua (Gjoni 16:13).
- Ai \_\_\_\_\_ mua (Gjoni 16:7, 8).
- Ai \_\_\_\_\_ mua (Romakëve 8:26).

4. Cila e vërtet është më domethënëse për ju?

5. Si mund ta ndikojë sjelljen tuaj në sporte njohja e kësaj gjëje?

Qëndrueshmëria në Krishtin është çelësi i përjetimit të fuqisë së Tij në çdo moment. Lexoni Gjonin 15:4, 5.

6. Nga e merr fryti ushqimin e tij?

7. Çfarë ndodh nëse dega nuk është e lidhur me shermëndin?

8. Çfarë të pengon të jesh i qëndrueshëm në Krishtin?

Tek Efesianëve 5:18, ne jemi urdhëruar të mbushemi me Frymën. Pali nxjerr në kontrast të qenit i dehur me verë dhe të qenit i mbushur me Frymën. Me fjalë të tjera, ti ose do të kontrollohesh nga Fryma ose nga diçka tjetër. Qëllimi ynë i pjekurisë në Krishtin detyron që ne të jemi të lidhur siç duhet me Frymën në marrëdhënien tonë me Krishtin.

**“Ai që është i Krishterë është i Krishterë sepse është i lidhur siç duhet me Krishtin. Por ai që është shpirtëror është shpirtëror sepse është i lidhur siç duhet me Frymën.”**

9. Lexoni Galatasve 5:18-23. Krahasoni të Krishterin e mbushur me Frymën dhe atë që jeton në mish (me përpjekjet e tij):

Jetesa në Frymë	Jetesa në Mish

--	--

10. Cilat cilësi të jetesës në Frymë do të donit që të zhvillonte? Si zbatohet kjo në konkurrimin tuaj?

### **E VËRTETA E ZBATUAR**

Dikush mund të pyes, “Çfarë ndodh kur dështon së qëndruari në Kishtin dhe lejon mëkatit të të vjedh prej pranisë së Tij?”

Ja se çfarë mund të bësh:

A. **Merr parasysh** (*mendoje me kujdes*) *veten* “i vdekur për mëkatit dhe i gjallë për zotin” (Romakëve 6:11). Nëse ke vdekur për mëkatit, nuk ka fuqi mbi ty. Pse jo? Kujto, një person i vdekur nuk mund të reagojë! Ti nuk je më skllav i mëkatit. Mëkati yt është shkruar në kryqin e Krishtit dhe është varrosur përgjithmonë.

B. **Rrëfe** (*bjer dakord me Zotin për diçka që është e vërtet*) *mëkatit*; quaje ashtu siç është. Bjer dakord me këto 3 gjëra:

1. *Quaje mëkat* — një sjellje ose veprim që ishte shenjë mos bindjeje.
2. *Quaje të falur* — Ai të ka falur tashmë me nëpërmjet vdekjes së Krishtit (Kolosianëve 2:13, 14).
3. *Thirre Zotin të të ndryshojë* — besoi Zotit që të ndryshoj veprimet e tua dhe sjelljen në mënyrë që të të çoj drejt Tij dhe larg mëkatit tënd.

C. **Dorëzoja** (*hiq dorë*) kontrollin e jetës tënde Jezusit (Romakëve 12:1,2) dhe kërkoi Atij të të mbush me Frymën.

Kjo kërkon besim (duke besuar fjalën e Zotit se Ai do ta bëj). Ashtu si atleti ka nevojë të nxjerr dyoksid karboni dhe të thith oksigjen, ashtu edhe i Krishteri ka nevojë të nxjerrë mëkatën dhe të thith premtimin e Zotit për të qenë i mbushur me Frymën. Kjo quhet “frymëmarrje shpirtërore”. Ju mund të merrni frymë shpirtërisht duke shprehur dëshirën për të ecur me Zotin nëpërmjet kësaj lutjeje:

*“At i dashur, kam nevojë për Ty. E kuptoj që e kam drejtuar vetë jetën time dhe kam mëkatuar ndaj teje. Faleminderit që mëkatet e mia janë falur dhe që kam fuqinë të jetoj mbi mëkatin. Të ftoj të marrësh vendin tënd në jetën time dhe të më mbushësh me Frymën e Shenjtë siç më ke premtuar ta bësh nëse e kërkoj me besim. E bëj këtë lutje në emrin e Jezusit”.*

Përgjatë javës:

1. Mendoni tre hapa praktikë që do të ndihmojnë të qëndroni në Krishtin.
  - a.
  - b.
  - c.
2. Kur jeni në situata që ju tundojnë të mëkatoni, edhe në mes të konkurrimit, ju mund:
  - Ti kërkoni Zotit forcën për të rezistuar ndaj tundimit dhe të kuptoni se ju jeni i vdekur për atë mëkat.
  - Rrëfeni menjëherë mëkatën tuaj ndaj Zotit dhe kërkoni fuqinë dhe kontrollin e Tij në jetën tuaj.
3. Mësoni përmendësh Galatasve 5:16.


*“Dhe unë them: Ecnit sipas Frymës dhe nuk do ta përmbushni dëshirat e mishit,”*

## **PËRFUNDIMI**

E njëjta fuqi që ringjalli Jezusin nga të vdekurit tani jeton në ju në mënyrë që ju vazhdimisht të ecni me besim, duke qenë të transformuar në imazhin e Zotit në çdo rrethanë.

***Parimi #3:  
Të qenit i mbushur me  
Frymën ju jep fuqinë të  
jetoni një jetë të  
Krishterë të  
aëndrueshme brenda dhe***

# A reflektion konkurrimi juaj mirënjuhje ndaj Zotit?



Mësimi 7  
**PERFORMANCA QË I SJELL LAVDI PERËNDISË**

*“Adhuroni në Frymë”*

*Ditën e nesërme ishte Dita e Hapjes së fillimit të sezonit të ri në NFL. Kundërshtari ishte Seattle Seahawks, por përsëri tema e mbremjes ishte diçka krejt ndryshe. Më shumë se një dyzinë Cincinnati Bengals ishin rreshtuar në dhomën e hotelit të Anthony Muñoz dhe Max Montoya. Antonio më kërkoi të qëndroja. Pjesa më e vështirë e natës ishte më e madhe se shqetësimi i ditës tjetër. Bëhej fjalë për të ardhmen e tij.*

*“Nuk e di se pse po luaj”- kjo ishte deklarata e tij e thjeshtë*

*“ Më pëlqen të luaj. Kurrë nuk kam luajtur për para ose famë. Nuk jam i motivuar nga shpërblimet ose çmimet që mund të marr. Thjesht nuk e di as vetë se përse po luaj”*

*Ishte një deklaratë e thjeshtë. Mendja ime vrapoi me vrull. Shumë shpejt më shkoi mendja tek sezoni i kaluar. Antoni ishte personi i parë që u zgjodh nga skuadra e*

*Cincinnati Bengals dhe i treti në të gjithë Federatën. Sezoni i të zgjedhurve ishte një sukses i vërtetë. Ai e krijoi skuadrën e të zgjedhurve dhe ata morën shumë çmime. Ai kishte përfituar shumë nga sukcesi dhe përsëri bëri këtë deklaratë “Nuk e di as vetë se përse po luaj”.*

*Ndërsa unë dhe Antonio u ulëm tek krevati i hotelit, filluam të diskutonim se çfarë kishte për të na thënë Fjala e Perëndisë. Ndërsa zbuluam të vërtetat e Perëndisë së bashku, lindi një burim i ri motivimi që vuri në lëvizje karrierën e mbrojtësit më të famshëm në historinë e Ligës së Futbollit Kombëtar.*

*Antonio u bë lojtari i parë më i sukseshëm i çdo pozicioni që u zgjodh në 11 lojtarë të sukseshëm të njëpasnjëshëm në Pro Bowls. Ai mori çmimin lojtarit më të mirë të vitit, të NFL.*

*Dhe karriera e tij u kurorëzua me selektimin e tij si lojtarin më të mirë në 75 vitet e para të NFL.*

*Sekreti i suksesit të Antonios shtrihet jo vetëm në aftësinë e tij sportive dhe në punën e palodhshme, por gjithashtu, dhe ndoshta më e rëndësishmja, në rëndësinë i të qëniet i motivuar, për të cilën diskutuam atë natë tek Romakët 12:1-2.*

**E VËRTETA E ANALIZUAR**

<sup>1</sup> Po ju bëj thirrje pra, o vëllezër, për dhembshurinë e Perëndisë, që t'i paraqitni trupat tuaj si një flijim të gjallë e të shenjtë, të pëlqyeshëm për Perëndinë; *kjo është* shërbesa juaj shpirtërore.

<sup>2</sup> Mos u përshtatni me mendësinë e kësaj botë, por shndërrohuni, duke ripërtërirë mendjen tuaj, që të provoni cili është vullneti i Perëndisë – çka është e mirë, e pëlqyer dhe e përsosur për Të.

- *Vullnetin i tij I mire, I pëlqyeshëm dhe I përsosur—Romakët 12:1-2*

1. Kujt i drejtohet vargu 1 dhe është e rëndësishme ti kushtojmë vëmendje?

2. Për çfarë na “nxit” Pali ti ofrojmë Perëndisë dhe pse?

3. Çfarë është adhurimi?

4. Çfarë duhet të ndryshojë në mënyrën tonë të të menduarit? (Vini re ndryshimin midis fjalëve “konformim- përshtatje” dhe “transformim”)

5. Si transformohemi ne?

6. Çfarë fitojmë kur adhurojmë Perëndinë me një mendje të transformuar?

7. Cilat janë disa “gjëra” për të cilat falenderoni Perëndinë?

*Si do të dëshironit ti thonit faleminderit?*

*Përfshirja jote në konkurim do të reflektojë mirënjohjen tuaj.*

*Antonio vendosi të ofrojë një performancë lavdërimi ndaj Perëndisë. Ai gjeti metoda konkrete për të shprehur lavdërimin ndaj Perëndisë (ose për të adhuruar ose për të falenderuar Atë) për atë që kishte bërë ose madje që do të bënte (me besim) në dhe përmes jetës së tij. Ditën tjetër, Antonio përdori çdo lojë si një mundësi për falenderuar Perëndinë për nënën e tij! Ajo kishte rritur e vetme, pesë fëmijë, shpesh duke punuar dy ose tre punë për të sjellë ushqim në tavolinë, dhe ajo shkonte në të gjitha lojrat kur ai luante në Ligat më inferiore. Çdo lojë ishte një mundësi tjetër për të lavdëruar Perëndinë dhe për ta falenderuar Atë për dashurinë dhe ndikimin e saj në jetën e tij.*

*Ditën tjetër shkova në ndërtesën e stërvitjes së Bengals-it dhe kisha takim me traniern e skuadrës, Forrest Gregg. Traniern Greg kishte qënë në pari i përfshirë në këtë kampionat. Ai ishte gjithashtu burri që sipas traniert legjendar*

*Vince Lombardi ishte “lojtari më i madh që kishte stërvitur ndonjëherë.”*

*Gjatë takimit, unë e pyeta Traniern Greg, “Si luajti Antonio?”*

*Ai u qesh në fytyrë dhe filloi të thoshte, “Antonio dha performancën më mire që kam pare ndonjëherë nga çdo atlet dhe nga çdo sportist. Ai arriti që kapërcente çdokënd që ata vendosën kundër tij!»*

*Sekreti i Antonios? Ai kishte mësuar vlerën e të qenit I motivuar nga brenda dhe jo nga jashtë? I motivuar nga dashuria e tij për Krishtin, ai e lavdëroi Perëndinë përmes konkurimit.*

—Wendel Deyo, Sportistët në Veprim *Drejtori kombëtar (National Director)*

8. Lexo Luka 17:11-18. Përshkruani ndryshimin midis përgjigjeve të ndryshme të lebrozëve pasi janë u shëruan.

Të thuash “Faleminderit” është vetëm një përgjigje e duhur ndaj atij që të jep diçka. Bibla e konsideron mirënjohjen si një qëndrim adhurimi; një mënyrë që atribuon vlerën dhe meritën e një pesoni.

9. Cili është qëndrimi i Jezus-it ndaj lebrozëve? Pse?

10. Renditni disa gjëra për atë që jeni mirënjohës për personin tuaj dhe për anën shpirtërore.

11. Cila është një përgjigje e duhur ndaj dashurisë dhe mëshirës së sipas Romakëve 12:1-2?

12. Si e shprehni normalisht mirënjohjen?

Ka shumë mënyra që mund të thoni faleminderit Perëndisë. Shkruajini çdo mendim për secilin nga vargjet e mëposhtme:

Psalm 30:12 \_\_\_\_\_

1 Thesalonikasve 5:18 \_\_\_\_\_

Filipianët 4:6 \_\_\_\_\_

Hebrenjtë 13:15 \_\_\_\_\_

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

Në aktivitetet sportive, shprehja e mirënjohjes ndaj Perëndisë tregohet në performancën tuaj. Jezusi tha se urdhërimi më i madh është ta duash Zotin tend me gjithë zemër, shpirt, mendjen dhe forcën tënde (Marku 12:30).

Më poshtë janë treguar shembuj për secilin nga kategoritë sesi një sportist duhet shprehë dashurinë dhe mirënjohjen ndaj Perëndisë.

**Zemra** — Bëje punën tënde 100% pa marrë asnjë meritë

**Shpirti** — Mbështet dike që është më isukseshëm se ty

**Mendja**— Mbaj shënime kur shikon filma dhe mbaje mendjen tënde të përgatitur çdo lojë

**Forca** — Të jesh një person i integritetit- moralisht dhe teorikisht

13. A mund të vijë në mendje shembuj të tjerë?

14. Si ndikon dhënia e një performance që lavdëron Perëndinë, në mënyrën sesi konkurron?

15. Në ciën zone (zemra, shpirti, mendja dhe forca) do të doje të përmisoheshe, në stërvitje dhe konkurim (lojë)?

A luan me intesitet? A je gati mendërisht në çdo stërvitje? Në çdo lojë? A luan me integritet? Sa bërtisni shumë kur luani?

Këto janë të gjitha mënyrat që shprehin mirënjohje ndaj Perëndisë. Kjo është performance që lavdëron Perëndinë.

Gjatë javës:

1. Mbaj mend Kolosianët 3:23-24.

<sup>23</sup> Çfarëdo që të bëni, ta kryeni me gjithë zemër, si për Zotin dhe jo për njerëzit,  
<sup>24</sup> duke e ditur se nga Zoti do të merrni shpërblimin e trashëgimisë. Është Zoti Krisht Ai të cilit po i shërbeni..”

2. M poshtë shkruaj emrin e një personi ose të një ngjarje për të cilën jeni mirënjohës. Gjatë konkurimit (lojës) përfshinidhe kohën e stërvitjes, fokusohuni në të qenit mirënjohës dhe përdorni trupin, mendjen dhe shpirtin për të thënë- faleminderit.

## **PËRMBLEDHJE**

Të thuash Faleminderit është më shumë se një gjest i rrësjellshëm. Është një shprehje e mirënjohjes ndaj dikujt me gjithë qënien tënde: shprehje e fjalëve të lavdërimit, sacrificë. Perëndia dëshiron me gjithë zemër të dëgjojë dhe të shikojë mirënjohjen tuaj në lojë ose konkurim.

***E VËRTETA E  
THJESHTËZUAR  
Thërrisni faleminderit  
Perëndisë me gjithë  
mendjen, trupin dhe  
shpirtin tuaj.***

# Si reagoni ndaj provave që hasni në aktivitetin tuaj sportive?



*Mësimi 8*  
**VËSHIRËSI ME SIGURI**

*“Të Njihni Pjesëmarrjen në Mundimet e Tij”*

*Pasi kishte Fituar Tour de France në 1986 për herë të parë, Greg LeMond kishte gjithçka që kërkonte; famë, fat dhe një të ardhme të shndritshme përpara tij. Më 27 Prill, ndërsa ishte për gjueti, u godit aksidentalisht. Goditja preku shpinën, këmbët, krahët dhe duart. Manaxherët e skuadrës menduan se karrerierat e tij si çiklist kishte mbaruar këtu. Gregu vazhdoi të fitonte Tour deFrance s në vitin 1988 dhe 199.*

1, Si do të regonit pas një aksidenti si të Gregut?

Përballja me situata të pafavorshme mund të jetë një nga provat më të mëdha në jetën e një sportisti. Një dëmtim serioz, një sëmundje, rezultate të dobta ose situata të tjera, mund të shkatërroj shpresat dhe endrrat. Por Perëndia e shikon të gjithë pikturën. Ai mund ta përdor karrierën tuaj si sportist, si një laborator për përmbushur gjëra të mëdha në jetën tuaj, vetëm nëse e lejoni Atë.

Disa mund të thonë: “Kohërat e vështira nuk zgjasin gjatë ndërsa njerëzit e fortë po”.

Ky mësim do tju ndihmojë të kuptoni pikëpamjen e Perëndisë për pengesat, kështu mund ti përdorni ato si një gur ku mund të vendosni këmbën për tu ngjitur më lartë.

**E VËRTETA E ANALIZUAR**

*“Që të njoh Atë dhe fuqinë e ringjalljes së Tij dhe pjesëmarrjen në mundimet e Tij, duke u bërë vetë / ngjashëm me Të në vdekjen e Tij”*

*Filipianët 3:10*

**Prisni për Sprovat**

Shumë prej nesh do të donin të besonin se ne mund jetojmë pa përjetuar kohëra të vështira. Por Shkrimet provojnë se në një moment të caktuar, një mënyrë ose në një tjetër, secili prej do ti duhet të përballet me vështirësitë. Elbert Hibbard komentoi kështu për kohërat e vështira:

“Ato janë një shenjë se ne jemi gjallë”

2. Pse mendoni se sportistët befasohen kur ndeshen me sprovat?

3. Çfarë nga tregojnë vargjet e mëposhtme për sprovat në jetën tuaj?

*1 Pjetri 4:12* \_\_\_\_\_

*Jakobi 1:2* \_\_\_\_\_

*Gjoni 16:33* \_\_\_\_\_

4. Sa e dobishme është të dimë se kohërat e vështira janë një pjesë që priten të ndodhin në jetën tonë?

“Perëndia na pëshpërin në rehatinë tonë, na flet në mendjet tona, por therret në dhimbjet tona: ky është megafoni i Tij për të zgjuar botën e shurdhër”

### **Përqafoni Sprovat**

5. A ka përdorur Perëndia një sprovë për të tërhequr vëmendjen tuaj? Nëse po, si?

Si një sportist, ju e vendosni veten në stërvitje të mundimshme dhe të dhimbshme për të fituar formën më të mirë të mundshme për sportin që luani. Stërvitjet janë të përballueshme sepse arrini të shikoni se pas stërvitjes, janë qëllimet që doni të arrini.

Të përballeni me vështirësitë si të krishterë mund të jetë më e lehtë nëse shikoni se mbrapa vështirësisë ndodhen rrjedhojat e sprovave tuaja. Kjo nuk do të thotë se dhimbja do të largohet, por mund të të japë forcën dhe shpresën që ju nevojitet për të këmbëngulur.

6. Çfarë e mirë mund të dalë nga sprovat?

7. Thuhet se sprovat do tju bëjnë më të hidhur ose më të mirë. Çfarë është ajo “më e mira” që Perëndia dëshiron ti sjellë jetës suaj si rezultat i kohërave të vështira?

Romakët 5:3-5 \_\_\_\_\_

Romakët 8:28-29 \_\_\_\_\_

Jakobi 1:2-4 \_\_\_\_\_

1 Pjetër 5:6-11 \_\_\_\_\_

Kuptimi i fjalëve në greqisht të përdorura tek 1 Pjeter 5:10, mund tju ndihmojë të kuptoni se çfarë premtion Perëndia kur duroni sprovat:

8. Si ndikojnë këto vargje për pikëpamjen tuaj mbi sprovat?

**Të përsosur** = tju japë atë ju mungon, sprova mund të zëvendësojë dobësinë tuaj

**Të patundur** = tju bëjë të patundur si graniti, sprova e bën të palëkundur karakterin tuaj

**Tju forcojë** = tju mbush me forcë, sprova e rrit besimin tuaj

**Tju vëj themel**=tju stabilizojë në një vend, sprova siguron një themel të fortë për besimit tuaj.

9. Si përputhet kjo me “Qëllimin Hyjnor” që diskutuam në mësimin 2?

## **E VËRTETA E ZBATUAR**

“Ajo që ndodh rreth e rrotull teje është jashtë zonës së kontrollit tënd; mënyra sesi zgjedh të

10. Sipas këtyre vargjeve, si mund të regaoni ndaj sprovave që ato mund të ndikojnë në të mirën tuaj?

Jakobi 1:2 \_\_\_\_\_

Filipianët 4:4 \_\_\_\_\_

1 Thesalonikasit 5:18 \_\_\_\_\_

Filipianët 4:6-7 \_\_\_\_\_

11. Përmendni një sprovë që po kaloni në jetën tuaj:

12. Mbaroni fjalitë e mëposhtme sipas vargjeve të mësipërme në situatën që po kaloni:

- Unë mund të gezohem në mes të kësaj situatë sepse

---

---

---

- Unë mund të jem mirënjohës sepse \_\_\_\_\_

---

Gjatë javës:

1. Mbaj mend Jakobi 1:2-4

*“Ta konsideroni një gëzim të madh, o vëllezër të mi, kur ndodheni përballë sprovash nga më të ndryshmet, duke ditur se sprova e besimit tuaj sjell qëndrueshmëri dhe qëndrueshmëria të kryejë në ju një vepër të përsosur, që ju të jeni të përsosur dhe të plotë, pa asnjë të metë.”*

2. Lexoni Romakët 8:37-39. Lutuni sipas këtyre vargjeve duke ia përkushtuar situatat që po kaloni dashurisë dhe kujdesit të Perëndisë

3. Mendoni për një sprovë që po kaloni ose keni kaluar kohët e fundit. Duke përdorur 1 Pjetri 5:6-11, bëni një listë se çfarë kërkon Perëndia të zhvillojë në jetën tuaj.


## **PËRMBLEDHJE**

Sprovat janë pjesë e jetës së çdo njeriu. Do vijë një moment kur ju do të përballeni me vështirësi në jetën tuaj. Mos u befaso nga kjo. Sprovat janë të pashmangshme, kështu prisni që ato të vijnë – madje pëfaqojini ato! Mos u fokusoni tek problemi që keni; shikoni përtej situatave të tashme, fokusohuni tek e mira që Perëndia mund të ndërtoj në jetën tuaj. Ju mund të përjetoni akoma dhimbje në mes të sprovave, por duke e parë me sytë e Zotit, do tju japë kurajon për të vazhduar.

### **Parimi #4:**

***Sprovat janë një mjet që  
Perëndia i përdor për të  
zhvilluar një karakter të  
perëndishëm ndërsa rritemi***

# Çfarë ndodhet në vijën e finish-it që do tju bëj të vazhdoni të vraponi sot?



*Mësimi 9*  
***MBAJINI SYTË TEK ÇMIMI***

*“Drejtojini sytë tek Jezusi”*

*“Bregdeti i Kalifornisë ishte mbuluar nga mjegulla në mëngjesin e 4 Korrikut të vitin 1952. Njëzet e dy milje në perëndim të ishullit Katalina, një grua tridhjetë e katër vjeçe u hodh në ujë dhe filloi të notojë drejt Kalifornisë. Ajo ishte gruaja e parë që notoi njëzet e një milje në vijë të drejtë. Emri i saj ishte Florence Çaduik (Chadwick) dhe ajo ishte gruaja e parë që kishte notuar më parë në kanalin anglez në të dyja drejtimet.*

*Ujërat ishin akull të ftohta atë mëngjes dhe mjegulla ishte aq e dendur sa Çaduik mezi i shikonte varkat që e shoqëronin për të trembur peshkaqenët. Ndërsa orët ikin, ajo vazhdonte te notonte. Lodhja nuk kishte qënë ndonjëherë një problem serioz. i vetmi kërcënim ishte ftohtësia e ujit që mund të bllokonte gjymtyrët. Më shumë se 15 orë më vonë, e mpirë nga të ftohtët, notarja kërkoi ta nxirrnin nga uji. Nuk mund të vazhonte më. Nëna e saj dhe tranieri, në varkë afër saj, e nxitën të vazhdonte sepse ishte shumë afër bregut. Megjithatë ajo nuk shikonte asgjë përveç mjegullës së dendur. Disa minuta më vonë, notarja doli nga uji.*

*Më vonë, kur e kuptoi se kishte qënë vetëm gjysëm milje larg nga bregu, tha “nuk dua ta justifikoj veten, por nëse do ta kisha parë bregun do të mund tja kisha dalë mbanë”.*

*Florence Çaduik (Chadwick) u mund, jo nga të ftohtët, madje as nga lodhja por nga mjegulla! Mjegulla kishte turbulluar qëllimin e saj; kishte verbuar arsyen dhe sytë e saj.*

*Edited by Michael P. Green — Illustrations of Biblical Preaching, pg. 165, 166*

*“All of us who are mature should take such a view of things. And if on some point you think differently, that too God will make clear to you. Only let us live up to what we have already attained.”*

*Philippians 3-15, 16*

Jeta e krishterë nuk është një sprint. Nuk është gjithashtu as edhe një vrapim 100-metersh. Nuk është një vrapim një ose çerek milje. Por është një marathon. Është e rëndësishme për ecjen tone të përditshme me Krishtin të kemi “pamjen” e duhur për rrethanat e jetës sonë- si në fitore edhe në dështimet. Në mësimin 5 ne studiuam për për Hebrenjtë 11, Salloni i Besimit. Konteksti i këtij vargu në fakt fillon tek Hebrenjtë 10: 32 dhe pastaj vazhdon duke përshkruar se besimi ynë është një besim këmbëngulës. Të gjithë ne si sportistë e dime rëndësinë e këmbënguljes. Ne gjithashtu duhet të ndërjegjësohemi edhe rëndësinë e këmbënguljes në fushën shpirtërore. Hebrenjtë 11 shtrihen në kapitullin 12 dhe vargjet 1-3, veçanërisht vargu 2, do të studiohet në këtë mësim.

## **E VËRTETA E ANALIZUAR**

*“1 Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, të lëmë mënjane çdo pengesë dhe mëkatën që kemi përherë përreth, dhe të rendim me durim në garën që kemi përpara nesh.*

*2 Le t'i mbajmë sytë të ngulur te Jezusi, autori dhe përsosësi i besimit tonë, i cili për gëzimin që e priste, duroi kryqin pa përfillur turpin dhe u ul në të djathtë të fronit të Perëndisë.*

*3 Mos e hiqni nga mendja Atë që duroi një armiqësi të këtitillë nga mëkatarët kundër Tij, që të mos lodheni e t'ju lëshojë zemra.*

*Hebrenjtë 12:1-3*

Vija e Finish-it! Është si një goditje e adrenalines, që i jep inkurajim dhe shpresë besimtarit që ka vijën e finishit para syve të tij. Duke i mbajtur sytë tek Jezusi (kujtoni përdorni pikat e rëndësishme) do të motivoheni në ecjen tuaj të përditshme me anë të besimit në fuqinë e Frymës së Shenjtë, me një performance të shkëlqyer, duke adhuruar Perëndinë nëpërmjet konkurimit tuaj.

Hebrenjtë 12:1-3 na paraqesin 3 parime që do të na bëjnë të vazhdojmë përpara.

## **Vrapo i pangarkuar**

2. Çfarë duhet hidhni tutje?

Mëkatii është një qëndrim i veçantë ose një veprim që nuk e kënaq Perëndinë. Barrat janë ato gjëra, jo të mëkatshme, që ju rëndojnë.

3. Identifiko një barrë:

✠ në aktivitetin sportiv

✠ në ecjen tuaj me Zotin

## **Vrapo larg**

4. Si ndikon besimi dhe fuqia në Frymën e Shenjtë në këmbënguljen tuaj?

5. Vargu 1 thotë: “rendi në udhën përpara jush”. Çfarë “gare” po garoni për të cilën kërkohet këmbëngulje?

## **Vrapo duke parë**

6. Çfarë do të thotë “ti drejtosh sytë” diku?

7. Kush është Jezusi sipas vargut 2? Pse është thelbësore kjo gjë?

8. Cila është arsyeja që e aftëson Jezusin për të duruar dhimbjen dhe turpin në kryq?

9. Pse në vargun 3na thuhet ta kujtojmë Atë?

Nëse Jezusi pa përtej kryqit, atë e do të vinte më pas, sa më shumë ne duhet të shikojmë tek Ai dhe tek vija e finish-it me qëllim që të durojmë të ftohtët dhe mjegullën si pjesë të jetës sonë.

**Të mos ndalosh për asnjë  
arsye është rruga e  
shkurtër drejt suksesit!**

### **E VËRTETA E ANALIZUAR**

*Në vijën e finish-it ju do të jeni të ngjashëm me Të.:*

10. Me fjalët e tua, përbllidh mesazhin e Palit tek 1 Korintasve 15: 50-58

11. Çfarë lloj ndryshimi nevojitet dhe pse nevojitet ai?

12. Parafrazoni vargun 58 lidhur me situatat aktuale që po kaloni?

13. Krahasoni këtë varg me Gjoni 3:1-3. Kujt do ti ngjani kur të arrini në vijën e finishit?

14. Tregoni një karakteristikë të Jezusit që ju e doni ta keni në jetën tuaj?

*Në vijën r finish-it, ju do të jeni **me** Të:*

15. Tek Thesalonikasit 4:13-18, çfarë arsye na jep Pali për ti kujtuar besimtarët të se do të jenë me Zotin?

16. Krahasoni këto vargje me Zbulesën 21:1-8. Çfarë fjalësh janë përdorur për të përshkruar qiellin e ri?

17. Perëndia do ti bëj të gjitha gjërat e reja! Shkruani se si do të jetë jetesa në praninë e Perëndisë?

18. Të diturit se do të jeni si Krishti dhe me Krishtin përgjithmonë, si ndikon kjo gjë në këmbënguljen tuaj të përditshme në jetën si I Krishterë? Po si një sportist ?

Gjatë javës:

1. shkruani një një kartë 3x5 një qëllim për:

Vraponi të pangarkuar:

Vraponi larg:

Vraponi duke parë:

2. Mbani mend Filipianët 1:6 bëjini ato tuajat.

*“Duke qënë I bindur për këtë se Ai që e nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezus Krishtit.”*

3. Rishkruajeni Filipianët 1:6 me fjalët tuaja.

---

---

---

---

---

## **PËRMBLEDHJE**

### *Vija e Finish-it*

Qoftë në aktivitete sportive ose në jetë, ne të gjithë e dimë se ka një vijë finishi. Vija e finishit nuk është fundi por është kalimi nga kjo njëra anë e përjetësisë në tjetrën. Jeta e përjetshme nuk ka të bëjë me sasinë e kohës por me ciësinë e jetës.

Ndërsa provoni praninë e Perëndisë në këto parime, kuptoni se jeta juaj do të jetë më mirë për të gjithë përjetësinë!

*Përtej Konkurimit është Fitorja!*

### **Parimi #5:**

***Duke i drejtuar sytë tek  
Jezusi, autori dhe  
plotësonjësi i besimit tonë,  
aë ngjall shporesë dhe forcë***

# THE PRINCIPLES OF ATHLETIC COMPETITION


1. *Dashuria e Krishtit është baza (ose objekti) I motivimit tonë në çdo gjë që bëjmë.*
2. *Duke jetuar me anë të besimit, duke besuar në Perëndinë dhe në premtimet e Tij, është e vetmja mënyrë për të përjetuar me të vërtetë praninë e Zotit.*
3. *Duke qënë të mbushur me Frymën e Shenjtë, ju jep fuqi për të jetuar jetën e krishterë si jashtë edhe brenda fushës. .*
4. *Provat janë një vegël që Perëndia për të zhvilluar një karakter të perëndishëm ndërsa rritemi më shumë në*

## SPORTISTI I KOMPLETUA



**Pikat Kryesore  
ju kujtojnë për  
qëllimin dhe  
fuqinë e  
Perëndisë ndërsa  
konkuroni.**

## Qëllim i



**Thuajini  
Zotit  
Faleminderit  
erit me  
mendjen,  
trupin  
dhe  
shpirtin**

## **SHTOJCA**

*Materiale të përdorura*

*Athletes in Action newspaper*, AIA Headquarters, P.O. Box 588, Lebanon, Ohio 45036

*The Competitive Woman magazine*, AIA; Integrated Resources, (1-800-729-4716)

*The Total Athlete*, AIA; Integrated Resources, (1-800-729-4716)

*Devotions for Athletes*, Patterson, Leroy; Baker Books

*Good Morning, Lord*, (for athletes), Martin, Paul; Baker Book House

*Our Great & Awesome God*, Johnson & Schierbaum; Wolgemuth & Hyatt, Inc., 1989

*Practice to Win*, Jones, Larry; Tyndale House, 1982

*Seeds of Greatness*, Waitley, Denis; Denis Waitley, Inc.

*The Making of a Champion*, Meyer, Paul; SMI International

*The Point After*, Johnson, Elliot; Zondervan, 1987

*Triumph Born of Tragedy*, Thornton, Andre; Harvest House

*Winning*, Teaff, Grant; Word Books, 1985

*Winning Isn't Always First Place*, Groten, Dallas; Bethany House, 1983

*Cross Training Manual/Playbook for Christian Athletes*, Theissen,

Gordon; Cross Training Publishing (308-384-5762).

*Handbook on Athletic Perfection*, Neal, Wes; Cross Training Publishing

*Handbook on Coaching Perfection*, Neal, Wes; Cross Training Publishing

*Rise & Walk*, Byrd, Dennis; Zondervan, 1993

*Sports Spectrum magazine*, Radio Bible Class, Grand Rapids, Mich.

49555 85